

**VENDIM**  
**Nr. 204, datë 16.3.2016**

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA MINISTRIA E MBROJTJES  
TE RADIO TELEVISIONI SHQIPTAR, TË NJË SIPËRFAQEJE TRUALLI  
FUNKSIONAL, BRENDA TERRITORIT TË PRONËS NR. 188,  
ME EMËRTIM “BATERI PZ”, ME VENDNDODHJE NË SAUK, TIRANË, DHE PËR  
NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003,  
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT  
TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË  
NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”,  
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15, shkronja “c”, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar dhe të nenit 114, të ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Mbrojtjes te Radio Televizioni Shqiptar, të sipërfaqes truall funksional, prej 1 500 (një mijë e pesëqind) m<sup>2</sup>, brenda territorit të pronës nr. 188, me emërtim “Bateri PZ”, me vendndodhje në Sauk, Tiranë, sipas planvendosjes që i bashkëlidhet dhe është pjesë përbërëse e këtij vendimi, për ta përdorur për ndërtimin e një stacioni transmetimi, në shërbim të rrjetit numerik të transmetimit DVB-T2, të Radio Televizionit Shqiptar.

2. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar, nga truall funksional i pronës nr. 188, me emërtim “Bateri PZ”, me vendndodhje në Sauk, Tiranë, të hiqet sipërfaqja truall funksional prej 1 500 (një mijë e pesëqind) m<sup>2</sup>.

3. Radio Televizionit Shqiptar i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit të sipërfaqes së pronës, të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, ta tjetërsojë atë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.


4. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes, drejtori i Përgjithshëm i Radio Televizionit Shqiptar, Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave të Paluajtshme dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI**  
**Niko Peleshi**

**PLANVENDOSJE E PRONES NR. 188**  
**( Bateri PZ. Sauk, Tiranë )**  
 Sipërfaqja që kërkohet për transferim nga MM te RTSH

Sistemi i Koordinatave Globale, UTM



SHKALLA 1:2500

PUNOI  
 Topograf Ramiz HAXHIU

DREJTORI I IGJIU  
 N/Kolonel Zydi **ALCANI**



Ripunuar 11.01.2016